

**VENDIM**  
**Nr. 673, datë 2.9.2020**

**PËR PAJISJEN ME NUMËR TELEFONI CELULAR TË FUNKSIONARËVE**  
**PUBLIKË**

*(Ndryshuar me VKM nr. 855, datë 4.11.2020; nr. 1176, datë 24.12.2020)*

*(I përditësuar)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 16, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Punonjësve të administratës publike, bazuar në funksionet që kryejnë, u ofrohet shërbimi i telefonisë celulare, sipas specifikimeve të këtij vendimi. Shpenzimet për këtë shërbim, në nivel vjetor, të jenë jo më shumë se 2% e totalit të shpenzimeve për mallra dhe shërbime të miratuara për çdo institucion në buxhetin vjetor përkatës. *Nga ky kufizim përjashtohen institucionet e pavarura me një numër jo më shumë se 100 punonjës dhe Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.*

2. Ky shërbim mund t’u ofrohet edhe me dalje ndërkombëtare dhe pa asnjë kufizim në mbulimin e shpenzimeve nga buxheti i institucionit funksionarëve, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Ky shërbim mund t’u ofrohet edhe me dalje ndërkombëtare, por jo më shumë se 40 000 (dyzet mijë) lekë në muaj, funksionarëve të përcaktuar sipas lidhjes nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Ky shërbim mund t’u ofrohet edhe me dalje ndërkombëtare, por jo më shumë se 30 000 (tridhjetë mijë) lekë në muaj, funksionarëve të përcaktuar sipas lidhjes nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

5. Ky shërbim mund t’u ofrohet edhe me dalje ndërkombëtare, por jo më shumë se 20 000 (njëzet mijë) lekë në muaj, funksionarëve të përcaktuar sipas lidhjes nr. 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

*5/1. Ky shërbim mund t’u ofrohet edhe me dalje ndërkombëtare, por jo më shumë se 10 000 (dhjetë mijë) lekë në muaj, për funksionin “Magjistrat dhe hetues në strukturat e posaçme kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar në sistemin e akuzës dhe gjykatave”.*

6. Ky shërbim mund t’u ofrohet edhe me dalje ndërkombëtare, por jo më shumë se 7 000 (shtatë mijë) lekë në muaj, për funksionin “zëvendësministër”, *këshilltar/analist/ndihmës, në kabinetin e Kryeministrit, dhe “drejtor departamenti” në Kryeministri.*

7. Ky shërbim mund t’u ofrohet edhe me dalje ndërkombëtare, por jo më shumë se 4 000 (katër mijë) lekë në muaj, funksionarëve të përcaktuar sipas lidhjes nr. 5, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

8. Ky shërbim mund t’u ofrohet edhe me dalje ndërkombëtare, por jo më shumë se 2 000 (dy mijë) lekë në muaj, funksionit “drejtor drejtorie në ministri” (niveli II-b), si dhe çdo funksionari të barazuar në pagë apo me pagë përkatëse më të madhe se ky funksion, por që kryen funksione drejtuese. Në këtë kategori përfshihen edhe funksionet “këshilltar/zëdhënës shtypi në kabinetin e titullarit”, “drejtor në Shërbimin Informativ të Shtetit” që kanë pagë të këtij niveli, si dhe këshilltari ligjor dhe ekonomik në institucionet e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe në institucionet e sistemit të drejtësisë.

Për efekt të këtij vendimi, me termin “pagë” kuptohet paga e pozicionit për funksion, pa përfshirë shtesat mbi pagë për vjetërsi në punë apo shtesa të tjera mbi pagë, sipas legjislacionit përkatës.

9. Shërbimi i telefonisë *Roaming* u ofrohet pa pagesë për të gjitha telefonatat zyrtare të kryera nga jashtë vendit, për funksionin: zëdhënës shtypi i Presidentit, i kryetarit të Kuvendit dhe i Kryeministrit.

10. Drejtuesit e njësive të vetëqeverisjes vendore kanë të drejtë të urdhërojnë pajisjen me numër telefoni celular të personave zyrtarë, bazuar në detyrën që kryejnë dhe brenda fondeve të parashikuara në buxhetin vjetor, sipas specifikimeve të mësipërme. Shpenzimet për këtë shërbim, në nivel vjetor, të jenë në çdo rast jo më shumë se 2% e totalit të shpenzimeve për mallra dhe shërbime, të miratuara për çdo institucion në buxhetin vjetor përkatës.

11. Drejtuesit e njësive të fondeve speciale, njësive të qeverisjes qendrore publike, kanë të drejtë të urdhërojnë pajisjen me numër telefoni celular të personave zyrtarë, bazuar në detyrën që kryejnë dhe brenda fondeve të parashikuara në buxhetin vjetor, sipas specifikimeve të mësipërme. Shpenzimet për këtë shërbim, në nivel vjetor, të jenë në çdo rast jo më shumë se 2% e totalit të shpenzimeve për mallra dhe shërbime, të miratuara për çdo institucion në buxhetin vjetor përkatës.

12. Drejtuesit e shoqërisë tregtare, me kapital 100% shtetëror, kanë të drejtë të urdhërojnë pajisjen me numër telefoni celular të personave zyrtarë, bazuar në detyrën që kryejnë dhe në varësi të mundësive financiare që kanë, të miratuar nga organet përkatëse, sipas specifikimeve të mësipërme. Shpenzimet për këtë shërbim, në nivel vjetor, të jenë në çdo rast jo më shumë se 2% e totalit të shpenzimeve administrative, të miratuara në planin financiar përkatës.

13. Për ofrimin e shërbimit, për funksionarët e përcaktuar në pikat 2, 3 dhe 4, të këtij vendimi, njësitë e qeverisjes së përgjithshme lidhin kontratat për këtë shërbim me cilindo prej operatorëve të shërbimit telefonik të lëvizshëm, që veprojnë në vend, sipas legjislacionit në fuqi.

Në çdo rast, shërbimi i ofruar paguhet nga njësia e qeverisjes së përgjithshme, sipas faturës mujore për vlerën e shpenzuar.

*14. Për ofrimin e shërbimit për funksionarët e përcaktuar në pikat 5–12 të këtij vendimi lidhet kontratë individuale me cilindo prej operatorëve të shërbimit telefonik të lëvizshëm, që veprojnë në vend, për një numër të vetëm celular ose njësitë e qeverisjes së përgjithshme lidhin kontratë me cilindo prej operatorëve të shërbimit telefonik të lëvizshëm, që veprojnë në vend sipas legjislacionit në fuqi.*

*Detyrimi financiar, në rastin kur lidhet kontratë individuale, paguhet nga funksionari, i cili kompensohet nga institucioni, kundrejt dokumentit të blerjes së shërbimit të numrit telefonik celular, por jo më shumë se kufijtë përkatës mujorë.*

*Detyrimi financiar, në rastin kur lidhet kontratë nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, paguhet për shërbimin e ofruar nga njësia e qeverisjes së përgjithshme, sipas faturës mujore për vlerën e shpenzuar.*

15. Çdo tejkallim i limitit mujor të përcaktuar si më sipër nuk kompensohet me limitin e muajit pasardhës.

16. Vendimi nr. 864, datë 23.7.2010, i Këshillit të Ministrave, “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë, publikë”, shfuqizohet.

*Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet nga data 1 janar 2021.*

ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
Erion Braçe

## EMËRTESAT E FUNKSIONARËVE SIPAS LIDHJEVE TË PËRKATËSE

### **Lidhja nr. 1- pa limit**

1. Presidenti i Republikës
2. Kryetari i Kuvendit
2. Kryeministri
4. Kryetari i Gjykatës së Kushtetuese

### **Lidhja nr. 2 – 40 000 lekë/muaj**

1. Kryetar i Këshillit të Lartë Gjyqësor;
2. Kryetar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë;
3. Kryetar i Gjykatës së Lartë;
4. Prokuror i Përgjithshëm;
5. Drejtues i SPAK-ut/ Byro Kombëtare Hetimi.

**Lidhja nr. 3 – 30 000 lekë/muaj**

1. Avokati i Popullit;
2. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve;
3. Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit;
4. Zëvendëskryetar i Kuvendit/ zëvendëskryeministër;
5. Anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor;
6. Anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë;
7. Anëtarë të Gjykatës së Lartë/ Gjykatës Kushtetuese;
8. Ministri;
9. Drejtori i Shërbimit Informativ të Shtetit;
10. Titullar i institucioneve të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve;
11. Kryetar i Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë.

**Lidhja nr. 4 – 20 000 lekë/muaj**

1. Sekretari i Përgjithshëm në institucionet Presidenciale, Kuvend, Këshillin e Ministrave;
2. Drejtori i Kabinetit të Presidentit të Republikës, kryetarit të Kuvendit dhe Kryeministrit si dhe çdo funksionar në nivel politik ose në nivel drejtues i barazuar në pagë apo me pagë përkatëse më të madhe se ky funksion. Në këtë kategori përfshihen edhe funksionet “këshilltar në kabinetin e titullarit” që kanë pagë të këtij niveli.
3. Komisionerë dhe gjyqtarë të institucioneve të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve;
4. Drejtori i Përgjithshëm i Doganave;
5. Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve;
6. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.

**Lidhja nr. 5 – 4 000 lekë/muaj**

1. Sekretar i Përgjithshëm në ministri;
2. Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme, si dhe çdo funksionar në nivel drejtues i barazuar në pagë apo me pagë përkatëse më të madhe se ky funksion. Në këtë kategori përfshihen edhe funksionet “këshilltar në kabinetin e titullarit” apo “zëdhënës shtypi në kabinetin e titullarit”, që kanë pagë të këtij niveli.